



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 14, Datë 10.01.2018

MBI

SHTYRJEN E AFATIT TË TARIFËS SË PËRKOHSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA "ALBGAZ" SH.A., MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 90, DATË 07.06.2017 SI DHE KONTRATËS SË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR TË LIDHUR MES ALBPETROL SH.A. DHE ALBGAZ SH.A.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" si dhe nenit 16 dhe 17 gërma "ç"; 35; 36 dhe 80 pika 8 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin Gazit Natyror"; pika 8 e VKM nr. 848, datë 07.12.2016," Për Krijimin e Shoqërisë Albgaz sh.a dhe për Caktimin e Autoritetit Publik që përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të shoqërisë Albpetrol sh.a dhe Albgaz sh.a"; nenit 15 të "Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s", miratuar me Vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.01.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, për shtyrjen e afatit të tarifës së përkohëshme të transmetimit si dhe kontratës së transmetimit të gazit natyror të lidhur mes Albpetrol sh.a. dhe Albgaz sh.a.,

Konstatohet se:

- Shoqëria Albgaz sh.a. ka paraqitur në ERE një kërkesë për shtyrjen e afatit të kontratës së transmetimit të gazit natyror, mes shoqërisë Albgaz sh.a. dhe shoqërisë Albpetrol sh.a. me nr. 55/1 Prot. i Albgaz, datë 05.07.2017 dhe nr. 4608 Prot. i Albpetrol, datë 06.07.2017. Kërkesa vjen si rrjedhojë e shterimit të fuqisë juridike të kontratës së nënshkruar dhe miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 199, datë 24.11.2017.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 178, datë 08.11.2017, ka miratuar *Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror*, në zbatim të së cilës do të miratohet tarifa përfundimtare e transmetimit të gazit natyror.
- Shoqëria Albgaz sh.a. me shkresën nr. 85/1 datë 03.01.2018 ka depozituar në ERE aplikimin për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të gazit natyror.

- Deri në miratimin e tarifës përfundimtare të shërbimit të transmetimit, procesi kalon përmes konsultimeve apo seancave dëgjimore me palët e interesit, e do të kërkojë kohë.
- Në datë 31.12.2017 ka përfunduar fuqia juridike e vendimit nr. 155, datë 28.09.2017 të Bordit të ERE, me të cilin është vendosur mbi Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 05.01.2017–20.09.2017” deri në 31.12.2017.
- Në datë 05.01.2018 ka përfunduar afati i kontratës së transmetimit të gazit natyror mes shoqërisë Albgaz sh.a. dhe shoqërisë Albpetrol sh.a. me nr. 55/1 Prot. i Albgaz, datë 05.07.2017 dhe nr. 4608 Prot. i Albpetrol, datë 06.07.2017.
- Shoqëria Albgaz sh.a. nuk mund të ushtrojë aktivitetin e saj pa një tarifë për shërbimin e transmetimit dhe pa një kontratë të ligjshme.
- Me përcaktimin e një tarife përfundimtare për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, shoqëria Albgaz sh.a., duhet të hartojë një kontratë të re për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, e cila të reflektojë parashikimet e legjislacionit në fuqi, si dhe tarifën përfundimtare, siç do të miratohet me vendimin e Bordit të ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a, deri në datë 31.03.2018.
2. Miratimin e kërkesës së shoqërisë Albgaz sh.a., për ndryshimin e nenit 4 të kontratës së shërbimit të transmetimit të gazit natyror ndërmjet shoqërisë Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a. me nr. 55/1 Prot. i Albgaz, datë 05.07.2017 dhe nr. 4608 Prot. i Albpetrol, datë 06.07.2017, miratuar me vendimin e të vendimit të Bordit të ERE nr. 199, Datë 24.11.2017 si më poshtë:
 - *Afati i kësaj kontratë shteron në 31.03.2018. Kjo kontratë mund të zgjidhet përpara afatit me një njoftim paraprak me shkrim nga secila pale (2) muaj përpara datës së zgjidhjes, si dhe në çdo rast tjetër që parashikohet në këtë kontratë.*

3. Shoqëria Albgaz sh.a. të depozitohet në ERE, draftin e kontratës së shërbimit të transmetimit të gazit natyror për vitin 2018, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e këtij vendimi.
4. Drejtoria Juridike të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI